



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2366/Prot.
12

Tiranë, më 15. 7. 2020

URDHËR

Nr. 238, Datë 15. 7. 2020

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“BANKING DHE FINANCË TË APLIKUAR”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-
UT TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Banking dhe Financë të Aplikuar” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Banking dhe Financë të Aplikuar”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Banking dhe Financë të Aplikuar”, në Universitetin e New York-ut Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

RELACION

Bazuar në Udhëzimin Nr.1 datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, dhe në raportin e vlerësimit të ekspertëve të jashtëm, nga ana e MASR iu kërkua IAL Universiteti “New York Tirana” (UNYT) plotësim i mangësive në dokumentacionin si dhe rishikimi mundësive të ndryshimeve në programin e studimit Bachelor “Financë dhe kontabilitet të aplikuar”.

Brenda afatit kohor të parashikuar nga ky Udhëzim, Universiteti “New York Tirana” vuri në dispozicion të grupit të punës dokumentacionin plotësues si më poshtë:

- 1) Statuti i UNYT I miratuar me vendim Senati me 06.03.2020
- 2) Organigrama UNYT
- 3) Plani strategjik 2018-2022 dhe Plani Strategjik 2020-2025
- 4) Rregullorja e Universitetit
- 5) Marrëveshja e bashkëpunimit me Bankën Kombëtare Tregtare (Memorandum of Understanding)
- 6) Shtese në studimin e tregut të punës në sektorin bankar dhe financiar
- 7) Plani mësimor i rishikuar
- 8) Lista e përditësuar e stafit akademik dhe e ngarkesës së tyre.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm, grupi i ekspertëve të jashtëm të vlerësimit e gjykon të plotësuar dokumentacionin dhe

nga analiza e tyre vlerëson se plotësohen kriteret përkatëse për të cilat nuk kishte mundur të shprehej në raport për këtë program.

Bazuar në ndryshimet e bëra në programin mësimor nga ana e UNYT konstatojmë se nga ana e institucionit janë marrë parasysh pjesa më e madhe e rekomandimeve të shprehura në raportin e vlerësimit. Ndryshimet në programin e studimit sipas rekomandimeve të grupit të eksperteve të jashtëm konsistojnë në përmirësimin e programeve të lendeve të caktuara, zëvendësime apo spostime të tyre duke "e lehtësuar" programin nga ngarkesa teorike shkencore dhe përmirësimin e përmbajtjes profesionale me qëllim hyrjen më lehtë në tregun bankar dhe financiar të punës të të diplomuarve në këtë program.

Bazuar sa më sipër grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se program Bachelor në "Banking dhe Finance të Aplikuar" i plotëson kriteret duke e vlerësuar përfundimisht "POZITIV"